



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2022:064041

Datë: 13.12.2024

Numri i dokumentit: 06593507

K.DH.Shk II.nr.1646/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Banka Ekonomike” Sh.a me numër të biznesit 70177683, me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson kompania e Avokatëve “Arbëresh” me seli në Prishtinë, kundër debitorëve Kiosk “Bill Bondsteel” me numër të biznesit 70140084, me seli në fshatin Sojevë, Komuna Ferizaj, 2. A. B., me numër personal ... nga fshati Komuna Ferizaj, 3. S. N. me numër personal ... nga fshati ..., Komuna Ferizaj, dhe 4. B. B., me numër personal ... nga fshati ..., Komuna Ferizaj, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2020/22 të datës 30.04.2024, me datë 12.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Banka Ekonomike” Sh.a, me seli në Prishtinë ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2020/22 të datës 30.04.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.2020/22 të datës 30.04.2024, në dispozitiv të aktvendimit ka aprovuar si të bazuar prapësimin i debitorëve 1. Kiosk “Bill Bondsteel” dhe 2. A. B., ashtu që ka anuluar Urdhrin Përmbarimor P.nr.133/22 të datës 17.03.2022, i Përmbaruesit Privat Bardh B. Tasholli, dhe është përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori (*me pretendime sikur në ankesë*) duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anuloj vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2020/22 të datës 30.04.2024, dhe të bie vendim që edhe njëherë të shqyrtohet lënda në gjykatë. Mbi arsyet e lartcekura ka kërkuar nga gjykata të vendos si në propozimin e lartpërmendur.

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Banka Ekonomike” Sh.a., mbi bazën e dokumentit përmbarimor: Marrëveshje kreditore për kredi për biznes nr1519/2 e datës 09.09.2011 dhe Marrëveshje mbi Pengun nr. 1517/4/Fe e datës 09.09.2011, për realizimin e borxhit ndaj debitorëve në vlerë prej 2,434.44 euro deri në përmbushjen definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitorët 1. Kiosk “Bill Bondsteel” dhe 2. A. B., brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim pos tjerash ka theksuar se kredia është marr me datën 09.09.2011 në bazë të kontratës për kredi biznesi pagesën e fundit e ka realizuar në vitin 2015 e duke u nisur nga ky fakte edhe po të ishte mbetur obligim të gjitha obligimet që kinse kanë mbetur nga kjo kontratë janë parashkruar pra e kanë arritur afatin e parashkrimit absolut, pasi që ka kaluar më shumë se 7 vite nga data e krijimit të raportit të fundit në mes të palëve deri në ditën e dorëzimit të propozimit për përmbarim., pos tjerash i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi si i bazuar ndërsa urdhri përmbarimor të shfuqizohet.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimi i debitorit nuk është i bazuar në dispozitat e LPP-së, i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin si në dispozitiv.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata pas vlerësimit të dokumentit përmbarimor dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 372 dhe 373 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të (1978) tutje LMD-së, ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit e cila rrjedhë nga Marrëveshje kreditore për kredi për biznes nr1519/2 e datës 09.09.2011, është parashkruar.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se kërkesa e kreditorit e cila rrjedhë nga Marrëveshje kreditore për kredi për biznes nr1519/2 e datës 09.09.2011, është parashkruar.

Me dispozitën e lartcekur të nenit 372 të LMD-së përcaktohet se “ *Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtëra (kërkesat periodike) si kur është fjala për kërkesat periodike akcesore, sikunder është kërkesa e kamatës, ashtu edhe kur është*

ffjala për kërkesën periodike të atilla në të cilat soset vetëm e drejta sikundër është kërkesa e ushqimit, parashkruhen tre vjet nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë. E njëjta gjë vlen për anuitetet me të cilat në shuma të caktuara një herë përpara periodikisht. Paguhen kryegjëja dhe kamata, por nuk vlen për pagesat në kiste ose për përmbushje të tjera të pjeshme. Ndërsa me dispozitën e nenit nenit 373 të LMD-së përcaktohet se “ Vetë e drejta nga e cila rezultojnë kërkesat periodike parashkruhet për pesë vjet, duke llogaritur nga rrjedhja për pagesë e kërkesës më të vjetër të papërmbushur pas së cilës debitori nuk ka kryer dhënien. Kur parashkruhet e drejta nga e cila rezultojnë kërkesat periodike, atëherë kreditori humbë të të drejtën jo vetëm të kërkojë dhënie të ardhshme periodike që kanë rrjedhur për pagesë para këtij parashkrimi.

Nga dispozitat e lartcekura gjykata e shkallës së parë drejtë ka llogaritur afatin e rënies në vonës të kthimit të kredisë nga e debitori i parë që rrjedhë sipas Marrëveshje kreditore për kredi për biznes nr1519/2 e datës 09.09.2011 me afate të kthimit 36 muaj, kësti i parë pas lidhjes së marrëveshjes ka arritur për pagesë më datën 10.10.2011, ndërsa kësti i fundit i cili k arritur për pagesë është 10.10.2014 andaj rrjedhë që afati i fundit për kthimin e kredisë ishte data 10.10.2014, e që e njëjta është parashkruar në kuptim të nenit 372, dhe 373 të LMD-së, pasi që propozimi për përbarim është parashtruar me datën 17.03.2022, ndërsa për kërkesat sipas dhënieve periodike sipas kontratës së kredisë kanë kaluar 8 vite nga koha arritjes së kistit të fundit për pagesë e deri në momentin e paraqitjes së propozimit për përbarim, ashtu që ka kaluar afati prej 3 vitesh i përcaktuar në nenin 372 dhe afati prej 5 viteve i përcaktuar në nenin 373 të LMD-së, brenda të cilit afatë kohorë propozuesi ka mundur të ushtroj mjet juridik për mbrojtje gjyqësore.

Gjykata e shkallës së Dytë po ashtu vlerëson se Marrëveshja mbi Pengun nr 1517/4/Fe e datës 09.09.2011, në bazë të së cilave është mbështetur propozimi për përbarim dhe është lejuar urdhri përbarimor nuk plotëson kushtet ligjore të cilat parashihen sipas dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 dhe me nenin 5 par.2 i Ligjit për Procedurën Përbarimore, Ligjit për Procedurën Përbarimore, nr.05/L-118 të, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore ku në mesin e dokumenteve përbarimore në bazë të cilave organi përbarues mund të caktoj përbarimin është kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit si dhe edhe kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut. Me shikim në shkresa të lëndës kjo gjykatë ka vërejtur se kreditori propozimit për përbarim nuk i ka bashkangjitur regjistrin zyrtar të pengut ashtu siç kërkohet me dispozitat ligjore të lartcekura.

Gjykata e vlerëson se pretendimet ankimore të kreditorit se kemi të bëjmë me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar i të drejtës materiale, janë pretendime të pabazuara dhe të njëjtat nuk përbëjnë bazë për anulimin e aktvendimit të atakuar, pala kreditore me ankesën e paraqitur nuk ka ofruar asnjë arsye për të mbështetur pretendimet e saj ankimore se kemi zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ndërsa Gjykata gjithashtu duke u kujdesur sipas

detyrës zyrtare konstaton se aktvendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe i mbështetur në dispozita ligjore.

Gjykata e shkallës së dytë ka analizuar edhe pretendimet tjera të kreditorit por të njëjtat mbesin vetëm në natyrën deklarative dhe të pambështetura në prova konkrete siç parasheh dispozita 69 par.4 të LPP dhe si të tilla nuk janë relevante për vendosje ndryshe prandaj kanë rezultuar si të pathemelta të cilat gjykata ankimore vendosi të refuzojë ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi ta vërtetojë. Përndryshe, në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMA E SHKALLES SE DYTË
K.DH.SH.II nr.1646/24 me datë 12.12.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi